



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80 dhe 42/86), të nenit 3 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe të nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2003 merr:

V E N D I M
MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI ÇAKTIMIN E
LOKACIONIT ME DESTINIM PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË GJIMNAZIT
“XHEVDET DODA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit mbi caktimin e lokacionit me destinim për ndërtimin e objektit të gjimnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë nr. 01-353-1120 i datës 19.06.2003.

Neni 2

Alinea 1. e nenit 2 e Vendimit mbi caktimin e lokacionit me destinim për ndërtimin e objektit të gjimnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë, nr. 01-353-1120, i datës 19.06.2003, ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje:

“Me këtë Vendim caktohet lokacioni me destinim për ndërtimin e objektit të gjimnazit “Xhevdet Doda” dhe Qendrës Rajonale për Aftësim Profesional, në Prishtinë”.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR.353-1724 DT. 06.10.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri